



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 15.10.2024
15-10-2024 protdate

Nr. 2977 protnumber

28 > 7

FTESË PËR NEGOCIATË
PËR

AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR SHËRBBIMIN E
ART GRAFIKËVE PËR MAERIALET ZGJEDORE DHE MATERIALEVE INFORMUESE

Në mbështetje, vendimit nr.1195, datë 05.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” dhe vendimit nr. 172 datë. 03.09.2024 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore 2024”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do të realizojë “Shërbimin e art grafikëve për materialet zgjedhore dhe materilave informative”.

Objekti: Shërbimi i art grafikëve për matërialet zgjedhore dhe materialeve informative”.

Periudha e realizimit: Realizimi i kërkesave do të jetë 10 ditë nga kërkesat që do të vinë KQZ sipas tematikës së kërkuar.

Fondi limit i përcaktuar: fondi limit është në vlerën është 2,040,000 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës: Kontrata do të jetë për një peiurdhë deri më 31 dhjetor 2024 me qëllim realizimin në kohë të dokumentcionit që do të duhet për prodhim dhe informim.

Publikimi i ftesës për negociata: 15 Tetor 2024

Afati përfundimtar për paraqitjen e konfirmimeve nga media e shkruar/agjencia e specializuar është më datë 18 Tetor 2024 ora 16:00.



Konfirmimet për vazhdimin e negociatave: Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës 18 Tetor 2024 ora 16:00. Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura. Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4
Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Prodhimin e art grafikëve për materialet zgjedhore dhe materialet informuese", kriteret do të jenë si më poshtë.

Qëllimi: Prodhimi i art grafikëve për materialet zgjedhore (zarfa, procesverbal, vendime, fletë votimi) në funksion të zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2025 si dhe përgatitjen e e materialeve informuese në kuadër të informimit të zgjedhësve.

Objekti: Në prodhimin e art grafike do të përfshihen dizenjimi i materialeve zgjedhore, dokumenta zgjedhore, materialeve të dedikuara për vitin zgjedhor (veshje, badge, tabela identifikuese/sinjalizuese) në funksion të zgjedhjeve për Kuvend të vitit 2025. Kontraktuesi do të realizojë imazhe ku jepen orientime të ndryshme për ndjekësit në lidhje me kanalet e informimit, të dhëna statistikore, imazhe që bëjnë thirrje për ushtrimin e të drejtës së votës, postera/imazhe për shpallje, procese, aplikime, afate, infografe periodike me të dhënat e rezultateve gjatë proceseve zgjedhore dhe shpalljeve të rezultateve, dizenjimi i materialeve për shtyp, broshura, brandim.

I. SHËRBIMET QË KËRKOHEN TË REALIZOHEN:

- Koncepte vizuale (Visual Concepts). Shërbimi për krijimin e konceptit vizual, duke marrë parasysh ngjyrat, simbolet dhe kompozicionin artistik.
- Ilustrime të personalizuar (Custom Illustrations). Zhvillimi i ilustrimeve unike, të dorëzuara në formate vektoriale, për përdorim në media të ndryshme si printime, faqe web, dhe rrjete sociale.
- Prototipe grafike për website (website Graphic Mockups). Krijimi i prototipeve për dizajnin grafik të faqeve të internetit, me përfshirjen e UI/UX, grafikave të responsivitetit dhe



elementeve ndërvepruese.

- 4- Zhvillimi i logove (Logo Design & Branding). Krijimi i logos dhe elementeve të markës (si paleta e ngjyrave dhe tipografia), të dizajnuara për të qenë unike dhe të riprodhueshme në formate të ndryshme.
- 5- Dizajni i dokumentacioneve zgjedhore (procesverbale, vendime, zarfa), i broshurave dhe fletëpalosjeve (Brochure & Flyer Design). Krijimi i dizajnit të për dokuetacionin zgjedhor, për broshurat dhe fletëpalosjet me përfshirjen e grafikave të avancuara dhe optimizim për printim në rezolucione të larta.
- 6- Përgatitja për printim (Print-Ready Preparation). Shërbimi për përgatitjen e skedarëve për shtyp me parametrat e kërkuar nga printerët komercialë, përfshirë profilizimin e ngjyrave CMYK dhe tolerancat e prerjes.
- 7- Infografika të personalizuar (Custom Infographics). Zhvillimi i infografikave që paraqesin të dhëna komplekse në mënyrë të thjeshtë dhe vizualisht tërheqëse për të përmirësuar ndërveprimin e audiencës.
- 8- Postera për evente (Event Poster Design). Krijimi i posterave grafikë të personalizuar për evente, me dizajn dinamik dhe optimizim për shtyp në formate të mëdha.
- 9- Dizajni i materialeve të marketingut dixhital (Digital Marketing Collateral Design). Krijimi i banerave dixhitale, grafika për email marketing dhe përmbajtje për platformat e reklamimit.
- 10- Retushimi dhe rregullimi i imazheve (Photo Retouching & Manipulation). Retushimi dhe rregullimi i avancuar i imazheve, përfshirë përmirësimin e ngjyrave, heqjen e objekteve të padëshiruara dhe përmirësimin e aspekteve të ndryshme.
- 11- Prezantime profesionale (Professional Presentation Design). Zhvillimi i prezantimeve të avancuara vizuale me grafika dinamike, për konferenca, trajnime apo takime ndërkombëtare.
- 12- Shërbimi i animacionit të logo-s (Logo Animation Service). Animacion i logos për të përmirësuar identitetin vizual të kompanisë në video, prezantime, ose fushata online.
- 13- Zhvillimi i stileve grafike për unifikimin e komunikimit . Zhvillimi i një stili unik të dizajnit për fushatat e zgjedhjeve, për të krijuar një identitet të njohshëm dhe të qëndrueshëm.
- 14- Shërbimi i konsultimit për artgrafik (Graphic Art Consultancy Service) Konsultime për drejtimin artistik të projekteve, këshillim mbi trendet aktuale dhe teknikat më të mira për shërbimet artgrafike.

Këto zëra mund të shërbejnë si bazë për një kontratë gjithëpërfshirëse shërbimesh për projekte të artgrafikës dhe dizajnit.



II. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

1. është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
2. nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
3. nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
4. personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
5. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
6. nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
7. ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
8. nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
9. ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
10. kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Shënim: Për plotësimin e kërkesave të mësipërme mund ti paraqesim më vetdeklarim dhe përpara fazës së shpalljes së fituesit përfundimtar, shoqëria e renditur e para më pikë do të sjellë dokumentacionin provues.

III. KRITERET E VECANTA TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit për negociatë, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit të parashikuar për këtë shërbim. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:
 - *Për kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i*



- përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
-
2. Ofeta ekonomike: Operatorët do të duhen të paraqesin ofertën ekonomike të detajuar sipas 5 zërave të shërbimit të paraqitur më sipër në vlerën pa tvsh.
 3. Operatorët ekonomik do të paraqesin një projekt ide/ zgjidhje teknike/ propozim për realizimin e shërbime që kërkohen.

A- KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i ofertës ekonomike me të favorshme sipas pikëzimit të mëposhtëm:

- **Kriteret e përgjithshme: 20**
- **Kapacitet teknik dhe profesional 30**
- **Oferta financiare e shoqëruar me Projekt propozimin për realizimin e kontratës 50**

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al